

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

19.02.2025

Ora 12:02

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 1, depozituar nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt “Kundërshtimi i pikës nr. 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z. K. Bele, z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Përfaqësues nga Kuvendi

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të ankimore me nr. 1, të paraqitur nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt “Kundërshtimi i pikës nr. 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Është e pranishme trupa e plotë e KAS-it, janë të pranishëm përfaqësuesit e ankimuesit. Ju lutem për efekt proceverbali prezantohuni dhe njëherë shkurtimisht me mikrofon.

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Mimoza Arbi, Drejtore e Shërbimit Juridik në Kuvendin e Shqipërisë.

**Znj. E. Domi, përfaqësuese e Kuvendit:** Ervina Domi, këshilltare ligjore.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 19.02.2025*

**Znj. I. Valle, përfaqësuese e Kuvendit:** Ilva Valle, këshilltare te Shërbimi i Komisioneve.

**Z. E. Braçe, deputet:** Erion Braçe.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Atëherë është prezent përfaqësuesja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe administratës së KQZ-së. Kështu që sipas procedurës, pa humbur kohë fillojmë shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore duke ia dhënë fjalën përfaqësueses së Kuvendit për të parashtruar shkurtimisht argumentet dhe pretendimet e tyre lidhur me objektin e ankimit. Atëherë cili dëshiron nga ju që të flasë.

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Të nderuar! Kuvendi i Shqipërisë, ashtu siç e trajtuam dhe në seancën paraprake të zhvilluar para dy ditësh ka kundërshtuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pikën 2 të vendimit 83 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me rekomandimin që i ka adresuar Kuvendit, për mos futjen në procedura parlamentare ose për ndërprerjen e procedurave parlamentare për dy nisma, njëra është nismë deputeti e zotit Erion Braçe dhe lidhet me disa shtesa e ndryshime në ligjin 92, mbi tatimin mbi vlerën e shtuar dhe është dhe një nismë e Këshillit të Ministrave, projektligji “Paketa e maleve”. Në këndvështrimin që kemi parë pikërisht pikës 2 të vendimit 83 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve konstatojmë që ai vendim ka një tejkalim kompetencash të Komisionerit, kompetencat e tij ligjore dhe cënon ndarjen e pushteteve duke kufizuar të drejtën e Kuvendit për të shqyrtuar projektligje, duke sjellë kështu cënimin e parimit të shtetit të së drejtës. Komisioneri nuk ka kompetenca, autoritet të ndërhyjë në procesin legjislativ të Kuvendit. Rekomandimet e tij për të mos shqyrtuar projektligjet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

përbëjnë një ndërhyrje të paligjshme në funksionet e procesit legjislativ të Kuvendit. Kompetencat e Komisionerit kufizohen në administrimin e procesit zgjedhor. Gjithashtu në vendimin administrativ të Komisionerit nuk mund të kufizohen funksionet bazike të Kuvendit, të dhëna nga Kushtetuta. Rekomandimet e Komisionerit nuk mund të prevalojnë mbi kompetencat kushtetuese të Kuvendit, çënohet dhe pavarësia institucionale të Kuvendit nëpërmjet këtij rekomandimi. Kuvendi është i pavarur në ushtrimin e funksionet e tij, asnjë organ tjetër nuk mund të ndërhyjë në axhendën e tij legislative, pra për Kuvendin referuar jo vetëm që çënon disa parime kushtetuese, natyrisht ne nuk jemi në gjykim kushtetues, por jemi të detyruar të përmendim që nga ky rekomandim ne konstatojmë që çënohen disa parime kushtetuese të mënyrës së funksionimit të Kuvendit, si institucion i pavarur dhe si pushtet legjislativ, por tek vendimi i Komisionerit shikojmë që ai ka bërë një interpretim të zgjeruar dhe të vetë ligjit, ligjit të Kodit Zgjedhor, ligjit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Pra neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor nuk i jep Komisionerit kompetencë për të ndërhyrë në axhendën legislative. Neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor ka përcaktuar si ndalime, dhënien e përfitimit për një kategori të caktuar të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjen ekonomike apo sociale, uljen apo heqjen e taksave, vendosjen e amnistisë fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveç kur nisma kushtëzohen nga gjendjet e fatkeqësisë natyrore. Komisioneri me vendimin nr. 83 arsyeton se ndryshimet e propozuara nga një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin e ekonomik apo tregtar. Çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë barazinë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve dhe kështu argumenton Komisioneri në pikën 2 të vendimit 83. Ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit e mjeteve ligjore për qëllim elektorale, kufizimet apo ndalime të parashikuara në nenin 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor mund të jenë penguese edhe kur verëhet që akti që kërkohet të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 19.02.2025*

shqyrtohet apo miratohet nuk duket se do të përdoret për qëllime politike, elektorale por është vetë ligjvënësi ai që në këtë pikë e ka vlerësuar që për një kategori aktesh për periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve, ndalimi për miratimin e tyre është i domosdoshëm, përjashtim bënë vetëm rastet e gjendjes së fatkeqësive natyrore. Ky përcaktim është zgjeruar për shkak të prezencës të disa elementëve, të cilët po i përmendim. Norma synon të ndalojë akte që japin përfitime direkte për kategori të caktuara të popullsisë, pra në qoftë se i referohemi dispozitës së nenit 91, pika 4, Komisioneri e zgjeron këtë në çdo akt që ka ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik, pra ndryshe nga ç' thotë norma në aktin e Komisionerit e shikojmë që e ka zgjeruar interpretimin e përmbajtjes së normës. Interpreton normën si të aplikueshme dhe për akte që nuk kanë lidhje me qëllimin elektorale dhe nuk e provon që të kenë lidhje me qëllimin elektorale. Komisioneri bën një zgjerim edhe të pajustificuar të objektit të normës, pra përfshin akte që thjesht mund të krijojnë perceptimin e përdorimit për qëllime elektorale, konsideron si të ndaluar dhe akte që nuk duhet të përdoren për qëllime politike zgjeron fushë veprimin e normës tej kategorive specifike të përmendura në ligj. Pra arsyetimi i Komisionerit për Kuvendin paraqet disa mangësi të rëndësishme, nuk demonstron lidhjen direkte midis aktit dhe përfitimit të këtyre kategorive të caktuara që thotë neni 91/4, nuk provon elementët e favorizimit elektorale, bazohet vetëm në supozime të përgjithshme ose nga përmbajtja e përgjithshme që ka projektligji, i cili është në proces shqyrtimi në Kuvend. Pikërisht bazuar në të gjitha këto Komisioneri krijon një presupozim të paligjshëm, duke konsideruar se çdo akt me ndikim ekonomik si potencialisht problematik për procesin zgjedhor. Presupozon qëllimin elektorale pa prova konkrete, vendos barrën e provës në mënyrë të papërshtatshme, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, barra e provës i takon organit që pretendon shkeljen dhe për këtë shkak organi administrativ, Komisioneri duhet të provonte në akt se

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

çfarë shkelje ka konstatuar pikërisht nga këto dy ligje për të cilat ai rekomandon Kuvendin e Shqipërisë për të ndërprerë procedura parlamentare, për këtë arsye ne e kundërshtojmë rekomandimin e Komisionerit. Jua përmenda në seancën përgatitore, ky rekomandim vërtet nuk është i detyrueshëm në kuptimin ligjor për Kuvendin por ama në kuadër të dy institucioneve kushtetuese, dy institucioneve, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, respektimin dhe bashkëveprimin të punës të dy këtyre institucioneve dhe për gjithë procesin zgjedhor, pra në këtë këndvështrim, Kuvendi ishte i detyruar që të mos vazhdonte procedurat kur kemi rekomandim të Komisionerit pa u shqyrtuar kjo nga KAS-i, pa u trajtuar kjo pikërisht në këtë seancë shqyrtimi në KAS në lidhje me pretendimet e ngritura nga Kuvendi për sa i përket të dy projektligjeve të konstatuara në pikën 2 të vendimit 83 të Komisionerit. Nëse do t'i referohemi nismave mund të nisim nga nisma e parë që lidhet me “Disa shtesa e ndryshime në ligjin 92, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, e cila sipas Komisionerit cënon nenin 91, pika 4, po bie ndesh me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Po të shikojmë tekstin, përmbajtjen e projektligjit që është nismë deputetësh konstatojmë që kjo nuk favorizon një grup të caktuar dhe nuk ka efekt elektoral në kontekstin e qëllimit që ka hartuar ligjvënësi kur e ka miratuar nenin 91, pika 4, pra që ky ligj të bëhet me qëllim elektoral dhe të ketë ndikim të drejtpërdrejtë elektoral. Çfarë rregullon ky ligj? Çfarë synon ky ligj? I cili ka qenë kërkesë e shumëhershme e deputetëve, jo vetëm të gjitha grupimeve parlamentare dhe ajo çka është më e rëndësishme që edhe kur është shqyrtuar në parim projektligji, ky projektligj është miratuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e komisionit, pavarësisht se kujt grupeve parlamentare i përkasin, për shkak sepse të gjithë kërkojnë ta realizojnë pikërisht atë drejtësi fiskale, atë barazi fiskale që midis grumbulluesit të prodhimit bujqësor apo elektoral, peshkar apo pyjor dhe midis atij e shet këtë të grumbulluesi të ketë barazi fiskale dhe kjo do të realizohej nëpërmjet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

këtij amendamenti që bëhej në ligjin 92 “Mbi tatimin i vlerës së shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe jo vetëm që nuk ul taksat, jo vetëm që nuk ul ndonjë detyrim fiskal por barazon, pra e sjell paketën fiskale në barazinë fiskale që është e domosdoshme dhe e nevojshme për gjithë zhvillimin e zonave bujqësore, blektorale, rurale dhe njëkohësisht frenon dhe minimizon informalitetin që ndodh në këtë proces. Megjithatë këtu bashkë me mua janë dhe këshilltarët që e kanë ndjekur, prandaj ne kemi ardhur, përveç si Drejtoreshë juridike që jam e detyruar të vij dhe të përfaqësoj çështjet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë dhe këshilltarët që e kanë ndjekur dhe që e njohin në përmbajtje, me detaje projektligjin dhe jemi në gjendje të përgjigjemi për çdo shpjegim apo interpretim në lidhje me përmbajtjen e këtij projektligji dhe për ta argumentuar pikërisht atë çka lexuam dhe çfarë shpjegova pse vendimi i Komisionerit bie ndesh jo vetëm me parimet kushtetuese por dhe me kapërcimin e kompetencave të tij. Për sa i përket ligjit “Paketa e maleve” është një nismë e ardhur nga Këshilli i Ministrave. Është një nismë e cila është bërë shumë kohë para se të shpallej me dekret data e zgjedhjeve dhe të fillonte afati katër mujor, afati i parashikuar për procesin zgjedhor. Kjo nismë e Këshillit të Ministrave është përfshirë në konsultimin publik të Këshillit të Ministrave dhe në relacionin, në parashtrimet që kemi paraqitur pranë KAS-it ne kemi arsyetuar dhe kemi argumentuar pikërisht që janë 35 shoqëri civile që kanë dhënë opinione në lidhje me këtë paketë dhe kur ka ardhur në Kuvendin e Shqipërisë dhe është futur në programin dhe kalendarin e Kuvendit të Shqipërisë, ky projektligj kishte kohë që ishte në proces shqyrtimi dhe konsultimi nga Këshilli i Ministrave dhe në kontekstin tonë ky projektligj, procedurat që rregullon nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë elektoral, as duke përcaktuar një kategori të caktuar, por as duke parashikuar që ky efekt është i menjëhershëm, elektoral dhe do ndikojë në zgjedhjet dhe do të krijojë një balancë të pabarabartë midis forcave politike, subjekteve zgjedhore që kandidojnë për zgjedhjet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 19.02.2025*

e 11 majit 2025. Çfarë rregullon projektligji? Pikërisht rregullon procedurat administrative, mënyrën e organizimit, mënyrën sesi do të zhvillohen këto zona malore, sesi do të investohet në këto zona malore, sesi do të bëhet dhe kalimi i pronësisë në këto zona malore. Vërtet po të shikojmë nenin 91, pika 4 e ka si element kalimin e pronësisë, por ky vetëm si element që parashikohet aty nuk mund të merret automatikisht dhe të trajtohet sikur ky ligj e pengon. Ligji ka një sërë procedurash, aktesh ligjore, nënligjore që do të dalin, të cilat do të jenë shumë më vonë se vetë procesi zgjedhor dhe më pas shumë më vonë se 11 maji i 2025, për të dhënë efekte mbi grupe të cilat janë të papërcaktuara, përfitues i këtyre mund të jetë kushdo, mjafton që të respektojë kërkesat e ligjit dhe parashikimet e ligjit dhe aktet nënligjore që do të nxjerrë Këshilli i Ministrave në zbatim të tij. Kjo është në mënyrë të përmbledhur argumenta dhe pretendimet tona në lidhje me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të cilin ne e kundërshtojmë. Për detaje, për çfarë doni të sqaroni ne jemi të gatshëm për t'u përgjigjur.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Atëherë ne për të qenë edhe më të organizuar, po ia japim fjalën përfaqësueses së Komisionerit së KQZ-së.

**Z. I. Rusmali:** Mos ndoshta kanë nevojë përfaqësuesit e Kuvendit të shtojnë, të thonë ndonjë fjalë? Deputeti ka nevojë?

**Z. E. Çefa:** Dakord.

**Z. E. Braçe, deputet:** Nëse ma jepni fjalën, po patjetër. Dakord. Unë do të doja të sqaroja vetëm për nismën që është një iniciativë e imja dhe e depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Përveç nga pikëpamja formale, ajo çfarë tha zonja Arbi,


*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

që nisma është bërë, është shqyrtuar në parim në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit dhe atje është miratuar nga të gjitha palët prezent, përfshi Ministrinë e Bujqësisë. Ministria e Financave nuk ka qenë prezent po për përfshi Ministrinë e Bujqësisë, përfshi të dyja grupet parlamentare është thujse e njëjtë, ka diferenca fare të vogla me një nisëm tjetër shumë të hershme në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë që është edhe ajo një iniciativë individuale e deputetit Agron Duka, kryetar i Partisë Agrare Ambientaliste, edhe ajo nismë e shqyrtuar dhe e mbetur në mes, nuk e di arsye procedurale të vetë Kuvendit, siç ka mbetur dhe kjo për shkak të rekomandimit që ka bërë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Do doja t'ju sqaroja vetëm një element, që është historik sesi është trajtuar tvsh-ja e sektorit të bujqësisë në harkun e shumë viteve dhe sesi është sot. Praktikisht ka ndodhur që në vitin 2006 të vendosej tvsh në blerje nga fermerët 6% dhe tvsh në shitje nga grumbulluesit, nga përpunues, nga tregtarë vendas apo në eksport me 20%. Ndodhi më pas që barazua por ama u denatyrue skema e tatimit mbi vlerën e shtuar, që do të thotë u vendos 20% tvsh në blerje nga fermeri, nga bujku apo blektori dhe 20% në shitje, nga të tjerë faktorë përpunues, grumbullues, eksportues e kështu me radhë, me detyrimin që 20% që i llogaritej fermerit ishte subvencionim për të. Ndodhi degradimi i madh më pas, disa vite më pas u shkua prapë në 6% me 20, pra 6 në blerje të tatimit mbi vlerën e shtuar, në blerje nga fermeri por me kushtin që ky 6% do të ishte rimbursim për fermerin dhe 20% në shitje nga gjithë faktorët e tjerë të tregut. U degradua akoma më shumë, u bë 0% në blerje tvsh-ja tek fermeri dhe 20% në shitje nga tregtarët dhe i gjithë kapitulli i subvencionit të fermerit përmes kësaj tvsh-je u bë nul sepse sa kohë që tvsh-ja nga fermeri ishte 0% dhe subvencioni që është favor i drejtpërdrejtë për bujkun u bë 0%. Çfarë ka bërë nisma? Nisma ka sjellë skemën, në skemën natyrale të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe e dyta ka shfuqizuar kapitullin e subvencionit praktikisht ka rënë dhe është e kotë që është i

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

shkruar ende në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, sepse nuk është 0% dhe fermeri nuk merr më subvencion përmes kësaj skeme. Atëherë çfarë kemi bërë? Kemi bërë parashikimet në ligj që në vlerën përfundimtare të transaksionit, 1/6 ose pjesëtuar për 6 është vlera e tvsh-së së llogaritur në blerjen e fermerit, po jo si subvencion, pra jo si për bujkun, praktikisht i bie 20%, pra kemi vendosur, por me 20% në blerje nga bujku dhe norma 20% në shitje, tvsh e pagueshme është tvsh në shitje minus tvsh në blerje, ajo që praktikisht është skema ligjore që përmban ligji i tatimit mbi vlerën e shtuar për çdo sektor tjetër të ekonomisë apo për çdo transaksion tjetër në ekonominë kombëtare, kaq dhe shfuqizimin e kapitullit që tashmë ka rënë sepse fermerët nuk subvencionohen më përmes tatimit mbi vlerën e shtuar përmes kësaj skeme. Pra ai favor ka rënë, ne nuk bëjmë favor, ne kthejmë, thjesht dhe vetëm në natyralitet skemën e tvsh-së, tvsh-së e pagueshme me tvsh-në shitje me tvsh-në blerje, për efekt dhe të llogaritje së vlerës së saj. Të njëjtën gjë ka bërë edhe nisma, se s’dua tani ta lë mënjanë, të njëjtën gjë parashikon edhe nisma e kolegut Agron Duka. Ne e kemi bërë më të gjerë skemën për shkak, apo e kemi shtrirë tvsh-në dhe te produktet peshkore, pyjore që plotësojnë të gjithë gamën e prodhimeve bujqësore edhe blegtorale ajo që përbëjnë sektorin të themi. Për ta rregulluar edhe këtë sektor, siç kemi rregulluar dhe sektorë të tjerë. Kaq është, domethënë nuk është favor, duhet ta theksoj këtë gjë, nuk i bëhet kurrkujt favor, përveçse kthehet në ligjshmëri tatimi mbi vlerën e shtuar, ashtu siç është e parashikuar në ligjin e plotë për tatimin mbi vlerën e shtuar. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Atëherë proceduralisht po ia jap fjalën përfaqësueses së Komisionerit që të shtjellojë dhe ajo dhe të japi argumentat dhe prapësimet e veta dhe pastaj në qoftë se do të kemi pyetje për të dyja palët do të vijojmë debatin për çështjen. Fjala për ju!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Znj. I. Osmanaj:** Faleminderit! Me datë 6.02.2025 Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, KRIIK ka paraqitur në KQZ nëpërmjet protokollit denoncimit të administruar me numër regjistri nr. 4. Në këtë denoncim KRIIK parashtron se në seancën plenare të datës 30 janar 2025, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me 70 vota pro, projektligjin “Për një shtesë në ligjin 29/2023 “Për tatimin mbi vlerën mbi të ardhurat” të ndryshuar. Nga ky konsultim i faqes zyrtare të internetit të Presidentit të Republikës të Qendrës së Botimeve Zyrtare vërehet se ky projektligj nuk është dekretuar nga Presidenti dhe nuk është botuar ende në Fletoren Zyrtare. Komisioneri me vendimin nr. 73, datë 10.02.2025 vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi këtë çështje shqyrtimi administrativ. Bazuar mbi këtë denoncim jemi drejtuar personave përgjegjës pranë Kryeministrit dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për të depozituar prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi. Në datën 11.02.2025 kemi administruar nëpërmjet postës elektronike me email pretendimet të Kuvendit sikurse Kryeministrit. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën 4698/1, datë 26.12.2024 i ka dërguar për mendim Këshillit të Ministrave projektligjin jo qeveritar “Për një shtesë në ligjin 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Kjo kërkesë e Kuvendit është bazuar në pikën 2 të nenit 82 të Kushtetutës, ku parashikohet se projektligjet qeveritare i dërgohen për mendim, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Këshilli i Ministrave e vlerësoi pozitivisht iniciativën tip, në këtë projektligj dhe i sugjeroi marrjen në konsideratë të mendimeve të ministrave. Po në datën 11.02.2025 kemi administruar pretendimet e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kuvend, i cili ndër të tjera bën me dije se “Miratimi i këtij ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” nuk ka

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

shkelur nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij. Natyra e kufizuar e përfituesve, mungesa e e efekteve të menjëhershme dhe mungesa e favorizimit elektoral janë faktorë që tregojnë qartë se ky ligj nuk ka qenë një mjet për të fituar përfitime elektorale. Ligji është në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe është miratuar në përputhje me procedurat e duhura.” Marr shkas se nga ky projektligj Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi edhe kalendarin për periudhën nga data 20 janar deri 28 shkurt, të programit të punës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, konstatohet se fusha e veprimit për dy projektligjet, siç është projektligji “Për paketën e maleve” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” prekin politika të rëndësishme fiskale. Ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve. Ato mund të krijojnë procedim për përdorimin e mjeteve ligjore për qëllim elektorale. Kufizimet apo ndalimet e parashikuara në nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor mund të jenë penguese edhe kur projektligji që kërkohet të shqyrtohet apo të miratohet nuk duket se do të përdoret për qëllime politike apo elektorale, por është vetë ligjvënësi ai që në këtë pikë e ka vlerësuar që për një kategori të caktuar aktesh për periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, ndalimi apo miratimi i tyre është i domosdoshëm, përjashtimin e ka bërë vetëm për rastet e fatkeqësive natyrore dhe nëpërmjet vendimit nr. 83, datë 11.02.2025 Komisioneri vendosi pushimin e hetimit administrativ për denoncimin nr. 4 të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara dhe në pikën 2 vendosi t’i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjet “Për paketën e maleve” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

vlerën e shtuar”. Në datën 14.02.2025 kemi admistruar kërkesën ankimore nr.1 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të cilët ankojnë pikën 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që lidhet me rekomandimin për mospërfshirjen në seancë plenare të dy projektligjeve, pra projektligjit “Për paketën e maleve” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92, datë 24.07.2014”.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Tani desha që ta fokusojmë pak te çështja më konkretisht, domethënë pala ankimuese ngriti dy pretendime juridike që ne duam t’i ezaurojmë pak, çështja e kompetencës së Komisionerit për të dhënë rekomandime Kuvendit dhe duam nga ju që të na ilustroni pak. Pastaj për sa i përket themelit, cilat elementë, më konkretisht sesa janë vënë në vendim, nëse është e mundur gjithmonë, cilat elementë ka konsideruar Komisioneri që bien në kundërshtim me pikën 4 të nenit 91? Konkretisht pala ankimuese ilustroi me shembuj sipas tyre nuk qëndron, nuk ka efekte financiare, nuk favorizohet asnjë kategori e popullsisë dhe për këtë qëllim s’ka pengesë ligjore që të vijojë miratimin. Tani ju na sqaroni pak, Komisioneri ku i ka parë pengesat? Shkurtimisht, në mënyrë të përmbledhur dhe pastaj nëse ka pyetje të tjera nga kolegët.

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë, sikurse e theksova, të dyja projektligjet, të cilat janë të përfshira në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 20 janar deri në 28 shkurt konstatohen se kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe tregtar, pra te projektligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, projektligjin “Për paketën e maleve” parashikon kalimin e pronësisë si pasuri shtetërore duke vendosur tarifa simbolike për një kategori të caktuar të popullsisë, përkatësisht 1 euro. Ndërsa projektligji tjetër parashikon ulje të detyrimeve tatimore për një kategori të caktuar

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

të popullsisë. Pra, të dyja këto projektligje bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor nëpërmjet të cilit ndalohet miratimi i këtyre akteve në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve.

**Z. E. Çefa:** Kompetenca e Komisionerit të lutem, ku është bazuar Komisioneri që i ka dhënë vetes autoritetin për t'i rekomanduar Kuvendit që mos vijoni më me këto procedura? Apo pika...

**Z. K. Bele:** Më falni, për ta ndihmuar...

**Z. E. Çefa:** Po.

**Z. K. Bele:** Ju jeni te pika “dh” ku sipas jush...

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë sikurse është cituar edhe në vendim të baza ligjore Komisioneri ushtron kompetenca në zbatim të nenit 19, pika “d”, “p” dhe “n” dhe te pika “dh” është e saktësuar që “Kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuara me detyra dhe detyrime sipas ligjit”. Kjo është kompetenca në zbatim të vendimit.

**Z. K. Bele:** Dëgjo se pak a shumë relatori e filloi me të njëjtën pyetje që besoj do e prekim ose na intereson të gjithëve. Duke lexuar në vendim, në faqen 3, në paragrafin 3 ku arsyetohet racionalja e Komisionerit për të arritur në këtë vendim, analizon pikën 4 të nenit 91 dhe vendimin nr. 9 dhe mbasi shpjegon sipas tij cilët janë kategoritë e ndalimit, janë po e citoj: “Janë ato organe apo institucione të cilat e kanë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

kompetencën kushtetuese apo ligjore për t'i miratuar këto akte”, pra thotë është e qartë që miratimi i projektligjit është kompetencë kushtetuese apo Kuvendit të Shqipërisë, pra e konstaton drejtësisht Komisioneri dhe në paragrafin e fundit, po në atë faqe, mbasi flet për ndryshimet e propozuara kanë ndikim të drejtpërdrejtë, e mbyll paragrafin duke thënë “ato mund të krijojnë perceptim të përdorimit të mjeteve ligjore”. Pra, Komisioneri ka konstatuar që mund të krijohet perceptim i përdorimit. Pra jemi në fushën e perceptimit. Pra sipas jush ka ndikim të drejtpërdrejtë apo është perceptim i përdorimit të mjeteve ligjore? Se mua më duket pak...

**Znj. I. Osmanaj:** Miratimi i këtyre dy projektligjeve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zgjedhje, sikurse është cituar dhe në vendim sepse të dyja këto projektligje kanë favorizim për një kategori të caktuar të popullsisë.

**Z. K. Bele:** Çdo projektligj sjell ndryshime të caktuara. Vetë Komisioneri shprehet ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale, pra është duke perceptuar që mund të ketë ndikim. Për ta mbyllur ku dua të arrij, Komisioneri këtu ka bërë një rekomandim me shkrim. Ne kemi parë më përpara Komisionerin në dalje publike për çështje të veçanta ka bërë rekomandime, për ta ilustruar për shembull Komisioneri në mënyrë publike në mjaft raste është shprehur lidhur me nevojën e ndryshimit të Kodit Zgjedhor për të zgjatur afatin e regjistrimit me qëllim që të mundësojë votimin e diasporës apo më herët ka bërë rekomandime të ndryshme duke thënë që ndryshimet po duhen të bëhen në kohën e caktuar, të cilat janë të logjikshme. Në ato raste këto rekomandime ai i ka bërë në deklarime publike, duke mbajtur qëndrim publik si drejtues i institucionit edhe si institucion. A shikoni ngjashmëri midis këtij rekomandimi të bërë me shkrim ose a

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

është e njëjta situatë midis rekomandimit që Komisioneri ka bërë si pjesë e vendimit këtu me ato rekomandime që ka bërë në dalje të mëparshme?

**Znj. I. Osmanaj:** Gjykoj se nuk është e njëjta gjë për shkak se ne kemi administruar dy shkresa të ardhura nga Kuvendi mbi kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe për të vlerësuar të dyja këto shkresa e kemi parë të arsyeshme dhe e kemi vlerësuar që të bëhen pjesë e këtyre projektligjeve dhe këtij vendimi dhe ky rekomandim të bëhet pjesë e këtij vendimi duke qenë se lidhen gjërat me njëra-tjetrën.

**Z. K. Bele:** Unë jam dakord që Komisioneri mund të nisi shqyrtimin administrativ të një kërkesë të KRIIK-ut, ka kaluar pjesë të shqyrtimit administrativ, ka marrë një informacion nga Kuvendi, është diskutim tjetër pastaj nëse është në tagrin e Komisionerit apo jo kjo. Çështja është që unë vetëm doja të dija për ta mbyllur, për ta kuptuar më shumë se nuk kam qenë dhe në seancën paraprake, pra ne në mos gaboj është hera e parë që kemi një rekomandim me shkrim nga Komisioneri. Kemi pas vendime të mëparshme apo rekomandime të Komisionerit në mënyrë, në daljet e tij publike. Ka pasur ndonjë rast tjetër rekomandimi të Komisionerit me shkrim?

**Znj. I. Osmanaj:** Ka pasur tërheqje vëmendje për ato institucione publike që nuk kanë përmbushur detyrimet, po rekomandime duke qenë se s'kemi pasur...

**Z. K. Bele:** Si për shembull në rastin e institucionit?

**Znj. I. Osmanaj:**...në rastin e institucioneve që kanë bërë postime apo ripostime në faqet e tyre zyrtare, ju është tërhequr vëmendje që të mos i përsërisin më këto postime të kësaj natyre.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. K. Bele:** Po flasim për institucione të cilat janë...

**Znj. I. Osmanaj:** Institucione publike.

**Z. K. Bele:** ...në kompetencën e Komisionerit për t'i monitoruar, thjesht me këtë kemi kaluar në nivelin që ne monitorojmë Kuvendin, pra po barazojmë Kuvendin në nivel monitorimi me institucionet e tjera, bashki apo institucione të tjera, ministri, pak a shumë jemi në të njëjtën fushë. Pra nëse ne do të pranojmë logjikën e këtij vendimi po pranojmë që Komisioneri tashmë monitoron dhe Kuvendin në mënyrë të përditshme të fushatës, është korrekte kjo?

**Znj. I. Osmanaj:** Është një rekomandim.

**Z. K. Bele:** Dakord, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Po, zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për administratën dhe një pyetje për përfaqësuesit e Kuvendit. Për administratën pyetja është pse rekomandim dhe jo ndalim, pse nuk e ka ndaluar? Ndalimin e Kuvendit që të vijojë procedurat për miratimin e këtyre akteve deri pas formimit të qeverisë së re, pra t'ia lërë legjislaturës së ardhshme, pse rekomandim?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Znj. I. Osmanaj:** Nuk ka një dispozitë konkrete që t'i japë kompetencë Komisionerit për urdhërimin e ndalimit të këtyre projektligjeve në seancë, rekomandimi është gjë tjetër dhe ndalimi janë dy gjëra të ndryshme nga njëra-tjetra.

**Z. L. Braho:** Po se 91/4 për ndalim flet, që katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore, pra jemi te nxjerrja ligjore, por meqënëse i është referuar nenit 91, pika 4, pra ju thoni ky është argumenti, dakord. Pyetje për përfaqësuesit e Kuvendit, tani unë i pashë këto dy projektligjet, njëri është ky "Për paketën e maleve", a ka realisht ngut, që duhet të miratohet patjetër brenda kësaj legjislature ky projektligj?

**Znj. E. Domi, përfaqësuese e Kuvendit:** Atëherë siç e kemi shpjeguar dhe në materialin që kemi depozituar nuk vlerësoj që është treguar ngut deri tani, pra procesi është i kahershëm dhe është në procedurën e tij natyrale si çdo akt tjetër, i cili vjen dhe administrohet fillimisht në Këshillin e Ministrave dhe më pas nga institucionet e tij gjithashtu dhe nga Kuvendi. Pra që në tetor projektligji ka qenë i përfunduar dhe dalë në konsultim publik. Janë 765 klikime mbi ligjin, do të thotë që ka pasur një interes, jo të moderuar do të thoja unë po ndërkohë shoqëria civile ka klikuar, ka diskutuar e ka shqyrtuar. Pra në thelb, përtej pyetjes suaj e ka ezauruar edhe atë elementin të impaktit që mund të kishte në fushatën zgjedhore, por ai vazhdon të jetë një projektligj duke u shqyrtuar në Kuvendin e Shqipërisë, ka marrë kohën e nevojshme, nuk i është nënshtruar asnjë kërkesë për procedura të përshpejtuar, nuk ka kërkesë për hyrje në fuqi të menjëhershme të tij, pra është në rrugën e tij natyrale. Unë nuk shoh që aktualisht për këtë paketë të konsiderojmë apo të jemi në kushtet e një nxitimi. Është një ligj si çdo ligj tjetër, është në komisione parlamentare, po shqyrtohet në komisione për dhënie mendimi, akoma s'ka filluar shqyrtimi në

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Ka filluar thjesht një prezantim në Komisionin e Ekonomisë, duke dëgjuar thjesht prezantuesit, propozuesit e projektligjit, akoma s'kanë folur relatorët, akoma nuk është diskutuar dhe shqyrtuar. Ka grupe pune të ngritura për këtë qëllim, të cilët janë duke e shqyrtuar projektligjin, në të gjithë komponentët e tij, kështu që unë personalisht si përfaqësuese e Kuvendit nuk konstatoj që jemi në kushtet e një nxitimi.

**Z. L. Braho:** Pyetja ime ishte tjetër, pra a cënon ndonjë shtresë të caktuar të popullsisë në qoftë se nuk miratohet brenda kësaj legjislature? Pra në qoftë se pranohet, pra në qoftë se rri në fuqi rekomandimi, domethënë e kam më tepër te, me çfarë kuptoj unë ku e ka konsideruar Komisioneri këtë pjesën që u jep një lloj favorizimi është që kërkesat për blerje ose kontrata për blerje do jenë në vlerë simbolike 1 euro. Normalisht pasi bëhen ato studimet dhe të gjitha, pra kontrata e shitjes do të jetë 1 euro, në zonat malore në varësi të projekteve dhe besoj ky ka qenë perceptimi i Komisionerit që krijohet një lloj lehtësimi dhe te neni 15, te lehtësimi parashikon një numër maksimal subjektesh, 500 subjekte. Pra në qoftë se kjo nuk do të miratohet brenda kësaj legjislature a cënon ndonjë shtresë të caktuar të popullsisë?

**Znj. E. Domi, përfaqësuese e Kuvendit:** Së pari për të sqaruar momentin e çmimit simbolik 1 euro. Vërtet projektligji e parashikon këtë dispozitë, por ndërkohë do të kemi në konsideratë faktin që projektligji është referuar parashikimit fitues, e cila është tashmë një dispozitë e njohur nga Kodi Civil, duke përcaktuar kushte specifike, është e saktë, është e drejtë, është aplikuar si duhet Kodi Civil, kjo është një çështje që do t'i takojë diskutimit dhe shqyrtimit në komisione. Nëse do të ndikojë apo jo, kjo është një çështje që çdo vonesë në një proces të caktuar, i cili ka nisur, sigurisht që ka një impakt sado, unë nuk mund të vlerësoj sesa do të jetë ky impakt, por është

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

një proces tashmë i bërë publik, i njohur dhe mesa duket ka edhe interes nga poseduesit aktualë të tokës në këto anë dhe në këto vende. Sigurisht nuk do të jetë i menjëhershëm sepse siç e përcakton vetë projektligji do të duhet një kohë paraprake për të nxjerrë aktet nënligjore, do të duhet një kohë nga bashkitë për të studiuar dhe për të sjellë propozime pranë Ministrisë së Shtetit për këtë qëllim, Ministri i Shtetit gjithashtu do të bëjë vlerësimet e tij, pra i gjithë procesi do të kërkojë kohë, një shtyrje e mëtejshme, sigurisht që nuk do ta favorizonte procesin.

**Z. E. Çefa:** Keni pyetje? Po zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje për të mos ta ndërprerë fillin e mendimit këtu të prononcimet tuaja. Ju dini ngarkesën e komisionit, jeni këshillatë e komisionit apo jo? Ju dini ngarkesën e komisionit, çfarë ka komisioni në axhendë dhe kjo është një nga pikat e axhendës të komisionit, nga ana tjetër ju dini edhe sa zgjasin zakonisht diskutimet brenda komisionit, në rastet e këtyre llojve projektligjeve që janë, domethënë kanë një barrë pune të madhe. Nga ana tjetër praktika e Parlamentit është që në periudhën e zgjedhjeve puna reduktohet, deputetët shkojnë në bazë dhe merren me fushatën apo jo, aq sa perceptimi popullor është që Parlamenti shpërndahet, kur në fakt nuk shpërndahet por axhenda reduktohet. Sa gjasa ka që për shkak të këtyre rrethanave, ky projektligj të mos shqyrtohet, të mos miratohet brenda kësaj legjislature?

**Znj. E. Domi, përfaqësuese e Kuvendit:** Atëherë Komisioni i Ekonomisë ka një ngarkesë specifike, është ngarkesë aktualisht normale e krahasueshme me të gjithë periudhat e tjera në të cilën ky komision ushtron veprimtarinë. Siç e thashë projektligji tashmë është pjesë e shqyrtimit në grupe specifike pune të ngritura me

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

relatorët, me propozuesit, me staf tjetër të komisionit, me këshilltarët administrativë, pra komisioni është duke punuar. Nuk kam konstatuar deri më sot që të kemi një mundësi aktivitetit normal të komisionit, pra komisioni ka ushtruar funksionin e tij normalisht si në çdo periudhë tjetër, kjo edhe për shkak se është ndihmuar dhe nga rregullorja e Kuvendit, e cila ka përcaktuar dy javë veprimtari parlamentare, një javë është javë e gjelbër e cila i jep mundësinë të plotë të gjithë deputetëve të shkojnë në zonat e tyre zgjedhore dhe të kryejnë funksionet e tyre. Nuk konstatoj që kemi një vonesë, një ngadalësim të punës së komisioneve. Unë besoj që ky projektligj mund të kalojë, ka shumë gjasa të mira për të kaluar, nuk ka asnjë pengesë, është si çdo projektligj tjetër, i cili merr kohën e vet, dy, tre, katër javë për t'u miratuar.

**Z. I. Rusmali:** Për zonjën Arbi, në qoftë se mund të na ndihmoni, ju keni marrë pjesë në shqyrtimin administrativ të denoncimit të KRIIK-ut si Kuvend? Keni qenë në seancë që ka zhvilluar Komisioneri?

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Po, unë kam qenë në atë seancë për shqyrtimin administrativ të KRIIK-ut, për ligjin 29/2023.

**Z. I. Rusmali:** Për ligjin...

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Aty u ndodhëm, rastësisht dëgjuaam që nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dy pretendime në lidhje me këto dy nisma për të cilat po shqyrtojmë sot. Duhet të dini një gjë që Kuvendi kur miraton programin dhe kalendarin ajo diskutohet në konferencën e kryetarëve dhe aty shfaqin të gjithë deputetët mendime nëse duhet të jenë pjesë e kalendarit dhe programi, projektligjet. Aty është parë, diskutuar, janë diskutuar edhe këto dy

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

projektligje dhe është gjykuar dhe konferenca e kryetarëve ka gjykuar që të dy këto projektligje nuk përbëjnë pengesë referuar nenit 91, pika 4 për t'u shqyrtuar dhe për t'u bërë pjesë e kalendarit të punimit të komisioneve. Për sa i përket rëndësisë dhe nevojës që ka shqyrtimi, natyrisht që Kuvendi si organ legjislativ mbështet pikërisht nismat që lidhen me zhvillimin ekonomik të sjellë nga Këshilli i Ministrave, e cila ka dhe detyrimin dhe përgjegjësinë për zhvillimin ekonomik të vendit dhe referuar pikërisht rolit që ka Kuvendi, ajo e ka përfshirë në programin dhe në kalendarin e punimeve të saj dhe natyrisht dëshiron ta miratojë dhe këtë nismë të Këshillit të Ministrave, për t'i dhënë mundësi kryerjes së hapave të mëtejshëm që parashikon vetë ligji, për të zhvilluar pikërisht dhe këto zonat malore, të cilat parashikonte tek projektligji "Paketën e maleve". Mund të zgjasi, sa mund të zgjasi, këto janë çështje të diskutimit në komision, mund të jetë nevoja të krijojmë grupe pune dhe të përbashkëta me Këshillin e Ministrave, për të parë harmonizimin me kuadrin ligjor, me Kushtetutën, janë elementë të tjerë dhe ne tani nuk mund të themi sesa mund të zgjasi, por duke referuar praktikës normale të shqyrtimit të projektligjeve, ajo shhkon një muaj, mund të shkojë dhe dy muaj, por procesi zgjedhor nuk e pengon Kuvendin të zhvillojë normalisht veprimtarinë e tij në miratimin e ligjeve. Pra është e vërtetë që ka kufizime, kufizohen seancat plenare bëhen më të rralla, mund të bëhen gjatë 30 ditëshit të periudhës së fushatës, por jo që të ndërpresë veprimtarinë e Kuvendit. Pra Kuvendi gjithmonë mund të, është i gatshëm për të miratuar ato projektligje dhe natyrisht ato që kanë rëndësi dhe për ekonominë e vendit.

**Z. I. Rusmali:** Unë s'e kam bërë akoma pyetjen time, ju na dhatë një informacion të pakërkuar, po që mua më duket i dobishëm shumë në dritën e të dhënave që jep. Ju thoni që konferenca e kryetarëve e ka trajtuar efektin e nenit 91 në axhendën, punën e vet, e ka diskutuar dhe ka dalë në konkluzionin që projektet që janë pjesë e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

axhendës nuk bien ndesh me nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Siç e di unë, aq sa e di unë, konferenca e kryetarëve vendimet i merr me konsensus, do të thotë në këtë mbledhje kanë qenë të gjithë, domethënë ka qenë në përbërje të plotë konferenca e kryetarëve, ka qenë kolegët e opozitës në këtë konferencë? Në qoftë se kanë qenë edhe ata kanë qenë të opinionit që këto projektligje nuk e çenojnë, kjo axhendë e Kuvendit nuk e cënon dispozitën e nenit të Kodit?

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Kalendari dhe programi është miratuar në seancë plenare dhe jo në konferencën e kryetarëve.

**Z. I. Rusmali:** S'ka pasur konsensus?

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Po, s'ka pasur, po jo në këtë kontekst. Konsensusi janë për arsye të ndryshme.

**Z. I. Rusmali:** Po në këtë kontekst mund të na i zhvilloni një çikë çfarë opinionit kanë pasur deputetët e opozitës që përfaqësojnë atje në konferencë? Në qoftë se kanë pasur, se në qoftë se s'kanë pasur, s'kanë pasur nuk është e thënë.

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Nuk kam informacion.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Po ju merrni pjesë në konferencë vetë personalisht?

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Marrim pjesë në konferencën e kryetarëve, është bërë diskutim por nuk mund të them që është për këtë projektligj apo për...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Tani që të kthehem te pyetja ime fillestare...Po ju jeni pjesëmarrës...

**Z. E. Braçe, deputet:** Nëse mund të plotësoj diçka? Në komisionin parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, të dyja palët kanë qenë pro shqyrtimit, e kanë votuar me votë pro, domethënë edhe opozita edhe pozita. Ndërkohë që për ligjin tjetër “Paketën e maleve” është bërë thjesht prezantim, nuk është marrë ndonjë vendim në këtë gjë, thjesht është bërë një prezantim dhe pastaj është detajuar, relatori, vazhdon procedura parlamentare, kurse “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” është votuar në parim pro.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, zonja Arbi mos u mërzisni dua të kthehem prapë te seanca e shqyrtimit, denoncimit nga ana e Komisionerit. Ju keni qenë prezent, rreth këtyre dy projektligjeve që praktikisht u futën në axhendën e shqyrtimit, si të thuash nga dritarja, keni pasur mundësi që të bëni ju prapësimet tuaja, t’i thoni ju argumentat tuaja gjatë shqyrtimit nga Komisioneri?

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Ne atë ditë kemi ardhur dhe kemi argumentuar në lidhje me denoncimin që ishte bërë në lidhje me ligjin “Për tatimin”, ndërsa për këto të dyja ne u njohëm në atë mbledhje. Megjithatë, për sa i përket të dyja ligjeve ne kemi dhënë një sugjerim të shpejtë, të momentit para Komisionerit Shtetëror, duke pretenduar pikërisht këtë pretendim që ngremë edhe sot, që të dyja këto nisma nuk janë në ato ligje, të cilat parashikohen si ndaluese nga neni 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. E. Çefa:** Atëherë kam edhe unë një pyetje, pikërisht për këtë moment që u përmend nga ju. Ju besoj e dini apo jo qëllimin e ndalimeve që parashikon neni 91, është deri diku për të krijuar një klimë barazie të armëve gjatë, përpara dhe gjatë fushatës elektorale, ky është qëllimi në vetvete dhe pikërisht ky ka qenë besoj unë qëllimi i Komisionerit në rekomandimin, objekt i këtij ankimi. Tani pyetja ime për ju është: në qoftë se një përfaqësues partisë në pushtet në fushatë elektorale me banorët e zonave ku prek ligji “Për paketën e maleve”, thotë që ne po ju miratojmë një ligj, i cili do t’ju falim tokën që ju e keni prej disa vitesh në përdorim dhe këtë e bëjmë vetëm ne, se ne i kemi mjetet për ta bërë, a mendoni që kjo e cënon në fakt thelbin e ndalimit të nenit 91 të Kodit Zgjedhor?

**Znj. E. Domi, përfaqësuese e Kuvendit:** Ajo çka do të doja të evidentoja së pari është që çdo deputet i Republikës së Shqipërisë mund të bëjë propozime elektorale ashtu siç ai mendon, me apo pa ligj, madje do të thoja që edhe një deputet i opozitës nëse do të bashkonte votat për miratimin e “Paketës së maleve” do të shkonte do të thoshte që edhe ne e kemi miratuar “Paketën e maleve” dhe i kemi favore ju dhe ju kemi krijuar një mundësi të zhvilluar zonën, por ajo çka duhet theksuar është që paketa e maleve në vetvete nuk duhet parë si një premtim apo benefit, është benefit për zonën, ka në fokus zhvillimin malor të një ambienti të caktuar por që do të jetë objekt i rishikimit dhe i një studimi të thelluar të zhvillimit, pra nuk do të jetë thjesht për faktin që je një posedues real, pa titull i tokës për të përfituar automatikisht privilegjin.

**Z. E. Çefa:** Dakord, qartë. Në qoftë se nuk keni diçka tjetër për të thënë, tani shkurtimisht konkluzionet përfundimtare. Po, patjetër.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. Erion Braçe, deputet:** Kam një pyetje sepse e dëgjova me shumë vëmendje përfaqësuesen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe tha që nga ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar përfiton një kategori e popullsisë, cila është kategoria e popullsisë së përfiton?

**Znj. I. Osmanaj:** Vetë te projektligji citohet që ky projektligj ka një vlerë të caktuar për një pjesë të caktuar të popullsisë, po unë për momentin unë këtë nuk e kam që të ta citoj, por që... Mund të kem dy minuta kohë të lutem?

**Z. E. Çefa:** Dakord, në qoftë se zoti Braçe kërkon, ngulmon te një përgjigje shteruese atëherë dy minuta kohë.

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë për efekt të kësaj pike vlera përfundimtare, mund të vazhdoj?

**Z. E. Çefa:** Ndjesë, po vazhdoni.

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë për efekt të kësaj pike, citohet “Vlera përfundimtare e transaksionit është vlera për produktet bujqësore, blektorale, peshkore, pyjore etj. Tvsh-ja e përlllogaritur duke vlerësuar vlerën përfundimtare të transaksionit në koficientin 1.6”, pra nëse i bëjmë një interpretim kësaj dispozite kjo prek një kategori të caktuar, pra koficienti 1.6 prek një kategori të caktuar të popullsisë, në vlerësimin tonë kjo gjë.

**Z. E. Çefa:** Zoti Braçe!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. E. Braçe, deputet:** Më vjen keq!

**Z. E. Çefa:** Në qoftë se mundeni shkurtimisht për ne jo kompetentët dy fjalë na e perifrasoni pak.

**Z. E. Braçe, deputet:** Domethënë, praktikisht do të ishte në favor për një kategori të caktuar në qoftë se ishte 20 dhe bëhet 0, po kur është 0 dhe bëhet 20 nuk është përfitim, 0 në 20 e vendos legjislacioni. Vetë ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” thotë tvsh-ja e pagueshme është tvsh në blerje, tvsh në shitje minus tvsh në blerje. Praktikisht ne kemi 0 tvsh-në në blerje që do të thotë favori është 0, nuk është 20%, kur bëhet 20% nuk është favor dhe në këtë rast është rregullim i domosdoshëm ligjor që është krijuar kohë më përpara duke e konsideruar këtë 20% si subvencion i drejtpërdrejtë për fermerët, kur është bërë 0 dhe s’ka subvencion nuk ka favor, s’ka favor fare fiskal.

**Z. E. Çefa:** Po Ina shkurt tani.

**Znj. I. Osmanaj:** Po dhe një gjë e fundit, domethënë nisur dhe nga relacioni i cili është shoqëruar projektligjit, në argumentin e projektligjit citohet tekstualisht “Sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri ka një peshë të rëndësishme në ekonomi duke kontribuar me 20% dhe duke punësuar rreth 37% të fuqisë punëtore. Mbështetja e sektorit përmes politikave të duhura fiskale dhe rritjes së financimeve është një detyrim ligjor, i cili ka një prioritet strategjik dhe është një domosdoshmëri të punohet për të nxitur formalizimin e tregut në rritjen e produktivitetit.” Edhe kjo përbën një ndër arsytet që përfshihet në dispozitat e nenit 91, pika 4 të vendimit të Rregullatorit dhe të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Atëherë do të kalojmë... Kolegu Bele ka një pyetje!

**Z. K. Bele:** Më falni kisha dhe unë një pyetje shumë shkurt dhe desha t'ia drejtoja përfaqësuesve të Kuvendit. Pak a shumë është e njëjta pyetje që i bëra administratës por në të kundërt, tani kemi një rekomandim, i cili është bërë me shkrim, mund të ishte bërë me gojë. Për analogji për shembull unë po shikoja ligjin për Presidentin e Republikës, ku thotë neni 92, pika "a", i drejton mesazhe Kuvendit dhe në këtë kuptim mund të bëjë dhe rekomandime. Pra unë nuk e kuptoj domosdoshmërinë e këtij ankimi nga ana e Kuvendit, pra ankimi për një rekomandim, i cili në leximin tim Komisioneri mund ta kishte bërë dhe verbal, siç ka bërë në raste të tjera, po këtë rast ka zgjedhur që ta bëjë pjesë të këtij vendimi. Pra ardhjen e Kuvendit para kësaj trupe për të ankuar rekomandimin, domethënë këtu jam unë ndoshta pak i paqartë.

**Z. E. Braçe, deputet:** I nderuar zoti Bele! Pa më të voglin diskutim mund të kishte ndodhur dhe kështu, ashtu siç mund të ndodhte akoma më pozitivisht, verbalisht, të pyetej iniciatori, kështu që, të pyetej iniciatori për përmbajtjen sepse praktikisht nga ajo që kam dëgjuar në dy seanca Komisioneri e ka gjykuar apo administrata e ka gjykuar mbi bazën të titujve në kalendarin e punimeve të Kuvendit jo mbi bazë të përmbajtjes. Këtë dëgjova seancën që shkoi dhe këtë po dëgjoj edhe tani. Praktikisht unë jam përballë faktit që Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka ndërprerë diskutimin e projektligjit dhe pikërisht për këtë arsye kam kërkuar që të ankimohet, e kam kërkuar në seancë plenare, fill pasi kam dëgjuar njoftimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe natyrisht e kam kërkuar edhe këtu. Faleminderit Kuvendit që e mori parasysh edhe e donte ankimimin, por...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Z. K. Bele:** Pra ju thoni vendimi ka sjellë pasojën te rrugëtimi i aktit...

**Z. E. Braçe, deputet:** Po ka sjellë pasojën, sot është e mërkurë, komisioni ka qenë në punë ditën e hënë dhe ditën e martë, në të dyja seancat edhe të ditës së hënë edhe të ditës së martë, ne s'e kemi shqyrtuar vijimin e shqyrtimit nen për nen të projektligjit, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" në pritje të marrjes së një vendimi nga ana juaj, kështu që praktikisht jemi përballë një fakti edhe për shkak se në atë vendim të Komisionerit shkruhej që brenda kaq ditësh mund të bëni një ankim në KAS. Pra vendimi sugjeronte pikërisht dhe ankimimin e tij dhe për të qenë korrekt unë ia kam kërkuar Kuvendit të ecim përpara, e paguaj unë gjobën, po të ecim përpara, po s'e ka marrë njëri përsipër këtë gjë sepse tani unë kam 6 vjet që merrem me këtë gjë dhe s'dua të them ndonjë gjë, madje zoti Duka ka 6 vjet që merret me këtë gjë, 6 vjet të dy ne, deputetë po dhe kolegët e tjerë kemi 6 vjet që merremi me këtë rregullim ligjor. Ministria e Financave ka mbajtur një qëndrim konseguent etj., me radhë, ç'punë keni ju, e paguan konsumatori etj., me radhë. Në fakt ai që është favorizuar nuk është ajo po flet zonja me radhë po ai që është favorizuar kanë qenë gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë kombëtare që kanë skemë natyrale të tatimit mbi vlerën e shtuar e mbi të gjitha ekonomia, e gjithë vendeve fqinjë me ne, të cilët kur hyjnë në doganë hyjnë me 20% tvsh dhe dalin brenda tregut të brendshëm me 20% tvsh, pra favori ka qenë për ata, nuk është favori për ndokënd këtu brenda. Ne po kërkojmë barazi me këtë nismë dhe natyralizim të tatimit mbi vlerën e shtuar, siç ligji e parashikon qartësisht. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Pra, përfundimisht përfaqësuesi i Kuvendit kërkon?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

**Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit:** Ne kërkojmë shfuqizimin e pikës 2 të vendimit 83, datë 11.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Konstatimin se asnjë nga këto projektligje nuk bie ndesh me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe lejimin e vijimit të procedurave nga Kuvendi i Shqipërisë.

**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit! Përfaqësuesja e KQZ-së?

**Znj. I. Osmanaj:** Lënien në fuqi të vendimit nr. 83, datë 11.02. 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Z. E. Çefa:** Mirë, ju faleminderit! Atëherë përpara se ta ndërpresim seancën do më duhet të rakordoj pak me sallën, e kemi mundësinë që ta përdorim dhe pak apo ka takim? Sa mund të zgjasë mbledhja? Atëherë ne do ta ndërpresim këtu seancën, do të tërhiqemi në dhomë këshillimi dhe do ta shpallim në orën 15.00 sot vendimin. Sigurisht jeni të lirë që të mos të jeni të gjithë të prezent për shkak të axhendave. Atëherë një ndryshim të vogël, ju kërkojmë ndjesë, në orën 14.00 do ta lëmë takimin për shpalljen e vendimit, e afruam me një orë. Kaq, e ndërpresim. Në orën 14.00 këtu. Ju falemnderit!


***Rifillon seanca***

***Ora 14:08***

**Z. E. Çefa:** Përshëndetje! Riçelim seancën për shpalljen e vendimit. KAS pasi e konsultoi çështjen në tërësi, me shumicën e votave vendosi:

Pranimin e pjesshëm të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr.83, datë 11 shkurt 2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 19.02.2025*

Ky vendim hyn menjëherë në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Ndaj këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. U shpall sot me datë 19 shkurt 2025. E deklarojmë seancën të mbyllur.

**Vendimi nr. 7**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

